



# Buletini

## I INSTITUTIT TE SHENDETIT PUBLIK



*Institute of public  
health bulletin*



**NR. 4-2004**

# Buletini

i Institutit të Shëndetit  
Publik

Institute of  
public health  
bulletin

Nr. 4/2004




# Laboratori i Virologjise

## ROLI I LABORATORIT DHE NEVOJAT E TIJ NE RAST TE NJE SHPERTHIMI EVENTUAL TE INFLUENCES AVIANE

ALMA ROBO, BUJAR BRAHIMAJ

### *Virusi i Influences*

- Familja Orthomyxoviridae: tre type
  - Influenca A
  - Influenca B
  - Influenca C (nuk konsiderohet me shume rendesi)
- Ka genom me ARN te segmentuar (8 – 9 ) nje zinxhirore.



Karakteristikat e viruseve te gripit (sipas Kilburne)

		Virus A	Virus B	Virus C
Virusi i pare i izoluar	Aviar	1900	-	-
	Derri	1931	-	1982
	Human	1933	1940	1949
Struktura e virusit		8 – 9 fragmente	8	7
ARN e segmentuar				
Proteinat e struktures		7	7	6
ARN polymeraze-ARN vartese		+	+	?
Neuramidaze		+	+	0
Hemaglutinine		20°C	4 – 20°C	4°C
Variacione antigenike	Madhare			
	Minore	Minore	Minore	
Ribashkim genomik		+	+	?
Inhibimi replikimit	Aktinomicine D	+	0	?
	Amantadine	+	0	?
Temperatura e replikimit		35 – 37°C	33 – 35°C	32°C
Strehuesit ne natyre		Njeriu	Njeriu	Njeriu (Derri?)
		Kafshe, jo gjedh		

Semundja	Me e rende tek te rriturit sesa B	Me e rende tek te femijet sesa A Laringotrakeite Sind. Reye	Infekzion i lehte i traktit respirator te siperme
Epidemiologjia	Pandemi epidemi Raste sporadike	Epidemi raste sporadike	raste sporadike Infeksione subklinike
Njeriu	Epidem Infeksione subklinike portatore	0	?

### **Influenca A**

Klasifikohet ne nentipe ne baze te Hemagglutinines (H) 15 nentipe, and Neuraminidases (N) 9 nentipe { 2 Ag e kapsides }

Shtamet qarkulluese aktuale jane H1N1 dhe H3N2

Nentipet humane perfshijne H1N1, H3N2, H1N2, and H2N2

Nentipet Aviane perfshijne nga H1 tek H15 dhe nga N1 tek N9

Shpend ë Njeri H5N1, H9N2, H7N7, H7N2, H7N3

### **Influenza B**

Shkakton një semundje me pak serioze sesa Influenca e typit A

Nuk kategorizohet nga H or N si Influenca A

### **Influenca C**

I izoluar per here te 1re me 1949 tek njeriu

Me 1982 tek derri

Nuk eshte i njohur si perjegjes per epidemik

Influenca si një kercenim i Shendetit Publik

Viruset e Influences janë virusë respiratore të një rendesise shume të madhe për shendetin publik, veçanërisht Influenca A

Epidemiologjia, Prevenimi, dhe Kontroll i Influences; veçanërisht i Influences A

Pse eshte Influenza A kaq kercenuese per Sh-P?

Driftet antigenike (variaconet brenda nen-typeve HN) or shiftet antigenike (variaconet nen-tipeve ndryshme HN) bejne një pjesë të madhe të popullatës të pambrojtur nga ana imunologjike

Epidemite e Influences mund të karakterizohen si inter-pandemike ose pandemike

Dikur mendohej qe variante te reja te HN krijoeshin si pasoje e ripershtatjes se materialit genetik nga një shtam avian dhe një shtam human në një kafshe të trete, si derri. Evidenca të fundit sugjerojne qe njerezit mund të veprojnë si një ene perzierje

### **Per Shembull**

Nje derr ose person infektohet prej një influence aviane si H5N4 ne te njejten kohe qe derri ose njeriu infektohet me një shtam human si H1N1;

Gjate infeksioneve të dy genomet pershtaten ne një H5N1 (me H aviane dhe N humane)

Potencialet per Pandemi te Influences

Te gjithe viruset e influences mund te pesojne mutacion

I/A shkakton semundje tek njerezit

Midis njerezve ekziston pak ose aspak imunitet i tufes ndaj shtameve aviane

Nese viruset aviane marrin gene njerezore

Lehtesojne transmetimin person - person

Shqetësim i veçante eshte H5N1

**Historiku i Pandemive**

**1918-1919 Gripi Spanjoll , A (H1N1)**, 20-50 milion vdekje ne gjithe boten ,500,000 vdekje ne SHBA

Rreth gjysma e tyre ishin ne moshe te re dhe te shendeteshem

**1957-1958 Gripi Aziatik, A (H2N2)** U identifikua per here 1re ne Kine, Shkurt. 1957 ,U perhap ne SHBA ne Qershor 1957, 70,000 vdekje ne SHBA

**1968-1969 Gripi Hong Kong A (H3N2)**

I diktuar per here te 1re ne Hong Kong me 1968 . Ne fund te ketij viti u perhap ne SHBA Rreth 34,000 vdekje ne SHBA Virus qarkullon akoma edhe sot

Vendi yne vazhdimisht eshte perfshtire nga epidemi ose raste sporadike te gripit . Pothuajse cdo vit ne Laboratorin e Virologjise te ISHP- se jane izoluar dhe identifikuar shtame te gripit te cilat me pas jane konfirmuar ne Qendren Nderkombetare te gripit ne Londer. Keto po i pasqyrojme ne tabelen me poshte.

**Shtamet e gripit te izoluara gjate periudhes 1969 – 2005**

Viti	Nr. i shtameve	Nen/tipi i virusit	Shkaktari i epidemise
1969-70	19	A/Hong-Kong 1/68 (H3N2)	A (H3N2)
1971	10	B	Qarkullim ne kolektiva te mbyllura
1972	21	A (H3N2) A/England/5/72	A (H3N2)
1973-74	7	B/Hong-Kong/5/72 A/Port Chalmers/1/73 (H3N2)	B/Hong-Kong A (H3N2)
1975-76	22	A (H3N2)	A (H3N2)
1978-79	16	B/Hanover/3/78 A/Teksas/1/77 (H3N2)	B/Hanover/3/78
1981	13	A/Bang-Kong(H3N2) A/Teksas/1/77 (H3N2)	A (H3N2)
1982-83	14	A/England/333/82 (H1N1) B/Singapor/22/79	Qarkullim ne kolektiva te mbyllura
1984	8	A/England/333/82 (H1N1)	A (H1N1)
1985	9	B/URSS/100/83	Qarkullim ne kolektiva te mbyllura
1988	4	B/Viktoria/1/87	Qarkullim ne kolektiva te mbyllura
1989	9	B/Viktoria/2/87	B
1990	8	A/Singapor/11/87 (H3N2)	A (H3N2)
1993	2	A/Bejing/33/92 (H3N2) B/Panama/45/90	A (H3N2)
1995	6	B/Bejing/184/93	Qarkullim ne kolektiva te mbyllura
1996	1	A (H3N2)	Qarkullim ne kolektiva te mbyllura
2000		A/Singapor/5/97 (H3N2)	A (H3N2)

2001	3	A/Madagascar/57794/100 (H1N1)	A(H1N1)
2002	3	B/Sichuan/379/99	B
2003	2	B/Hong-Kong/330/01	A (H3N2)
	2	A/Panama/2007/99 (H3N2)	
2005	3	B/Hong-Kong /330/01	B

OBSH me shtamet qe jane ne qarkullim percatit vaksinen . Shtamet qe u parashikuan te qarkullonin per 2004 / 05  
A/Fujian/411/2002(H3N2) A/New Caledonia/20/99 (H1N1) B/Shanghai/361/2002

#### Shtamet qe parashikohen te qarkullojne per vitin 2006

A/New- Caledonia/20/99 H1N1  
A/California/7/2004/ H3N2  
B/Malaysia/2506/2004

#### Ç'eshte Avian Influenca (Gripi i pulave)

Eshte nje semundje njitese e kafsheve e shkaktuar nga viruse qe normalisht prekin vetem shpendet dhe me pak derrat Ndersa te gjitha speciet e shpendeve jane te prekshem ndaj infekzionit, shpendet shepiake(pulat)n Jane vecanerisht vulnerabel dhe infektimi i tyre arrin me shpejtesi permasa epidemike

#### Survejanca Globale

Eshte konfirmuar tek njerezit qe me 1997 , 1997 Hong Kong (H5N1)

- « Per here te 1re transmrohet nga shpendet - njerezit
- « 18 te konfirmuar, 6 vdekje
- « 1.5 milion pula ngordhen brenda 3 ditesh
- « Infekzioni i rralle person—person u konsiderua i mundshem 1999 Hong Kong (H9N2)
- « 2 femije, te dy u sheruan
- « Burimi i infekzionit — mishi i shpendeve

- « **Raste shtese H9N2 u raportuan nga Kina 98-99, 2003 Hong Kong (H5N1)**

- « 2 anetare familjeje qe udhetuan ne Kine
- « 1 u sherua, 1 vdiq; 1 shkak i paditur i vdekjes
- 2003 Hollande (H7N7)
- « Midis punonjesve te pularive dhe familjeve te tyre
- « U raportuan 84 raste, 1 i vdekur ishte veterineri
- « Symptomat ishin kryesisht infekSIONE te syve dhe disa edhe respiratore
- « Pati prova te transmetimit person - person

#### 2003 Hong Kong (H9N2)

- « 1 femije, u hospitalizua dhe u sherua

#### Pandemia e Influences

- Kriteret per nje pandemi humane
- « Shfaqja e nje nen tipi te ri te influences ndaj te cilil popullata eshte e pambrojtur nga ana immunologjike
- « Replikime tek njerezit e semundje

- « Transmetim person - person
- « H5N1 ploteson dy kriteret e para.

### Parashikimi i Pandemise

Pandemia e Influences nuk eshte si emergjencat e tjera te shendetit publik apo katastrofat e zakonshme.

- « Eshte e pa evitueshme
- « Arrin pa paralajmerim
- « Epidemi lokale eksplozive
- « Perhapet gjeresisht, nukeshte e fokusuar si psh. ndonje ngjarje bio-terrorizmi
- « Do te jape pasoja te jashtezakonshme per njerezit dhe burimet materiale
- « Efektet do jene relativisht te zgjatura javë — muaj

### Çeshtje Laboratorike

n Siguria e Laboratorit ( Mundesia qe nje infektion i gripit ne mase i shkaktuar nga nje infektion Avian i tipit A te virusit, mund te ndodh nga nje aksident ne laborator pranaj eshte shume i nevojsphem nje laborator i biosigurise i nivelit te trete ne menyre qe laboratori te mos jete shkaktar i perhapjes se infektionit.


- n Teknikat e kulturave indore
- n Kitet e testeve te shpejtë
- n HA/HI per zbulimin e nen-tipeve
- n Testimet me Immuno-fluorescence
- n PCR ( nuk behet ne lab. tone)
- n Tipizimet dhe nen-tipizimet molekulare ( nuk behet ne lab. tone)

#### Indikacionet per testim per A (H5N1)

n Te gjithe personat e hospitalizuar ose pacientet ambulatore me pneumoni te konfirmuar X-grafi ose me infeksione akute respiratore, semundje tjeter te ashper respiratore per te cilin nuk vendoset diagnoze

- n Histori udhetimi brenda 10 ditesh ne nje vend te prekur nga avian influenza
- n Temperaturë .380C Dhe nje nga shenjet
- n Kolle, dhimbje fytë, dhimbje muskujsh, diegie-lotim te syve, veshtiresi ne frymemarrje
- n Kontakt me shpende te semure

Laboratori i Virologjisë ka nje rol te rendesishem dhe ne perqatitjen e kuadrit qe do shkoje te marre materialin klinik. Rendesi shume te madhe ka marrja e materialit , ruajtja ne temperaturen e duhur dhe transportimi i tij ne laboratorin e Virologjisë ne ISHP.Kur materiali klinik vjen ne ISHP punohet sipas skemes se meposhtme



Krahas materialit klinik cdo rast me influece do te shoqerohet me nje skede ( skeda e mbledhjes se te dhenave ) qe paraqitur me poshte.

### **Skeda e mbledhjes te te dhenave Mostrat klinike**

Gjeneralitetet  
Data e fillimit te semundjes

Nr. ID	Tipi	Data e mbledhjes	Diagnoza klinike	Gjendja shendetesore	Shenime

### **Skeda e mbledhjes te te dhenave Mostrat pas vdekjes**

Gjeneralitetet  
Data e vdekjes

Nr. ID	Tipi	Data e mbledhjes	Diagnoza klinike	Gjendja shendetesore	Shenime

### **Laborator / Epidemiologjiisë**

Bashkepunim i epidemiologjisë me laboratorin per perforsimin e survejances se Influences

Aftesia e laboratorit per t'ju pergjigjur survejances

Bashkepunimi edhe me IKV

Veprimet dhe masat te kryhen sa me shpejte te jete e mundur.

## Programi i Zgjeruar i Imunizimit

### RISHPËRNDARJA E PAJISJEVE TË ZINXHIRIT FTOHËS

#### Pse u bë kjo rishpërndarje?

Pas inventarit të kryer për pajisjet e zinxhirit ftohës në Shqipëri u vu re se përsa i përket frigoriferëve dhe termobokseve:

- në disa rrethe kishte mungesa të theksuara në pajisjet e zinxhirit ftohës
- në rrethe të tjera kishte pajisje mbi nevojat që mund të kishte sektori epidemiologjik, konsultori i qytetit apo fshatrat e disa gendrave shëndetësore (ku aktualisht zinxhirin e ftohtë e luajnë termobokset).

Përsa i përket termometrave dhe stabilizatorëve nuk mund të bëhej fjalë për rishpërndarje pasi aktualisht ato nuk plotësojnë nevojat për të gjithë rrethet.

Sa pajisje u vlerësuan për rishpërndarje?

Në total u vlerësuan për rishpërndarje 168 pajisje nga këto 48 frigoriferë dhe 120 termobokse.


Ku konsistoi ajo?

Rishpërndarja konsistoi fillimisht në plotësimin e nevojave brenda rrëthit me 37 pajisje (16 frigoriferë e 21 termobokse), e më pas u pa mundësia e rishpërndarjes jashtë rrëthit me 131 pajisje (32 frigoriferë e 99 termobokse).

Sa u realizua?

Përsa i përket realizimit ai u arrit në total në masën 85%. Rishpërndarja e frigoriferëve u arrit në masën 63% dhe ajo e termobokseve në masën 94%. Rezultatet e rishpërndarjes janë paraqitur ne tabelën e mëposhtëm dhe në grafikun përkatës

	Planifikuar	Realizuari	%
<b>Total pajisje</b>	<b>168</b>	<b>143</b>	<b>85</b>
Brenda rrëthit	37	36	97
Jashtë rrëthit	131	107	82
<b>Total frigorifere</b>	<b>48</b>	<b>30</b>	<b>63</b>
Brenda rrëthit	16	15	94
Jashtë rrëthit	32	15	47
<b>Total termoboks</b>	<b>120</b>	<b>113</b>	<b>94</b>
Brenda rrëthit	21	21	100
Jashtë rrëthit	99	92	93



Arsyet e këtyre rezultateve të rishpërndarjes:

- § Lëvizja e pajisjeve
- § ka qenë më e lehtë brenda rrerhit, kjo duket qartë dhe nga përqindja e lartë e rishpërndarjes (97%).
- § Përsa i përket termobokseve, rishpërndarja e tyre ka rezultuar në masë të lartë, si brenda shtu dhe jashtë rrerhit.
- § Jashtë rrerhit rishpërndarja (82%) ka qenë më e vështirë për tu kryer përsa i përket frigoriferëve (47%) për dy arsyen:

1- Edhe pse mund të konsiderohen tepër disa frigoriferë, ato janë të domosdoshëm të qëndrojnë aty ku janë, pasi u takojnë fshatrave që janë shumë larg me qendrat shëndetësore e që shërbijnë në veteve si "qendra shëndetësore" përfshatra të tjerë rrerhit tyre, ose janë frigorifere qe punojne me vajguri ne raste emergjente.

2- Që nga koha e realizimit të inventarit e deri tani ka patur prishje të frigoriferëve egzistues, kështu që dhe ata që konsideroheshin tepër janë përdorur për plotësimin e nevojave brenda rrerhit.


### Situata e momentit

Sic u tha rishpërndarja e pajisjeve konsistoi vetëm në frigoriferë dhe termobokse, ndërkohë që për stabilizatorë dhe termometra është e njëjtë situatë si më parë.

Kështu, nevojat përpjekje të zinxhirit fitohës, në mënyrë që ai të funksionojë maksimalisht në të gjitha hallkat e tij mbetet si më poshtë:

Pajisje	Nevoja
Frigorifere (+2 - +8 °C)	22
Termobokse te vegjel	10
Stabilizzatore	614
Termometra	2269

Përsa i përket stabilizatorëve është paraqitur më poshtë sasia e nevojshme e tyre sipas nivelit; në sektor epidemiologjik, në konsultor qyteti dhe në qendër shëndetësore. Kjo për të parë realisht nevojat dhe për të konkluduar se ku duhet ndërhyrë sa më shpejt të jetë e mundur për plotësimin e nevojave me stabilizatorë nëse nuk do të arrihet të plotësohen të gjitha njëherësh. Vlen të theksohet se koha e qëndrimit të vaksinave në sektorët epidemiologjik është 3 muaj, e në konsultor dhe qendër shëndetësore 1 muaj. Por sigurisht qe konsultoret janë ato qe kane kohort me te madh ne krahasim me qendrat shendetesore keshtu qe dhe sasia qe mbahet ne to eshte dhe me e madhe



# Departamenti i Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive

## HETIM EPIDEMIOLOGJIK I NJË RASTI SUSPEKT RABIES NË RRETHIN E MATIT.

### ARTAN SIMAKU

#### Ç'është Rabies?


Eshtë një sëmundje zoonotike virale e shkaktuar nga virusi i tèrbimit që prek kafshët e egra dhe ato shtëpiake.

Në mënyre të rastësishme edhe njeriu.



#### Shpërndarja gjeografike

Kryesisht eshtë e përhapur në kontinentin e Azisë



#### Rezervuarët kryesorë të rabies

Ujku, dhelpra e kuqe, çakalli, baldosa, qelbësi, nuselala, lakuriqi i natës qentë e egër, janë rezervuarë, dhe burim infekzioni të rabies.

Kafshët shtëpiake si bagëtia e imët, gjedhët, kuajt, qëntë e shtëpisë të pavaksinuar janë zakonisht viktimi e sulmit të ujkut.

## Transmetimi

Transmetohet tek kafshët dhe njerëzit nga kontakti fizik me sekrecionet e kafshës së infektuar (kafshim, gërvishtje, lëpirje e lëkurës dhe mukozave të dëmtuara).

Njeriu zakonisht infektohet me anë të kafshimit të qenit të tèrbuar në qytete dhe të ujkut dhe dhelprës së kuqe në zonat pyjore.

## Patogeneza

Virusi i cili ndodhet në pështymën e kafshës së tèrbuar, hyn në organizëm dhe replikimin e parë e bën në miocite në vendin e kafshimit. Kjo fazë përkon me periudhën e inkubacionit.

Më vonë nëpërmjet nervave shkon deri në SNC dhe në të gjithë organizmin, nëpërmjet neuroneve periferike. Dëmtimet patognomonike të tèrbimit janë inkluzionet citoplazmike, trupëzat e Negrit. Përveç SNC dëmton gjendrat e pështymes, mbiveshkoret dhe pankreasin.

## Prezantimi klinik

Periudha e inkubacionit luhatet nga 10 ditë - 3 muaj.

Simptomat e para zakonisht janë jo specifike dhe perfshijnë aparatin respirator, gastrointestinal, sistemin nervor.

Pas disa ditësh zhvillohet në:

- *formën e vrullshme* - formën jo të vrullshme

Në të dy format ecuria është drejt paralizës së plotë dhe gjendjes komatoze. Vdekja vjen si pasojë e insuficiencës kardiorespiratore.

## Diagnoza

Kur anamneza është e qartë dhe simptomatologjia tipike dg. nuk paraqet vështirësi.

Faza prodromale paraqet vështirësi sepse mund të ngatërrohet me:

- Poliomielitin - Encefalitet virale - Tetanozin

## Diagnoza e vërtetë

*Diagnoza e vërtetë* e tèrbimit mbështetet në izolimin e virusit në tru, në pështymë, në likuorin c-s, sekrecionet konjuktivale, nazale, urinë.

*Diagnoza serologjike* bazohet në përcaktimin e titrit të antikorpeve në serum.

## Mjekimi

Mjekimi i plagës: shplarje me ujë dhe sapun, alkool, jod. Plaga nuk duhet të myllitet ose të suturohet.

Mjekimi specifik: injektim i serumit antirabik rrëth plagës, vaksinimi sipas skemës 0 -3 - 7 - 14 - 28.

Mjekimi simptomatik, antimikrobik, anti-tetanik kur është e nevojshme.

## Parandalimi

Vaksinimi i qenëve të shtëpisë dhe i kafshëve në zonat me risk. identifikimi, kapja dhe ekzekutimi i kafshëve të prekura nga tèrbimi.

Imunoprofilaksia para ekspozimit për profesionet në risk. Imunoprofilaksia dhe trajtimi i menjëherëshëm pas ekspozimit (kafshimit).

## Hetimi epidemiologjik i rastit

### Historia e rastit

Fëmija S. T. e datëlindjes 22. 12 .1994 nga fshati Gërman i rrëthit të Matit në dt. 01. 09. 2005 ditën e enje ora 2310 shtrohet urgjentisht në Repartin e Reanimacionit të Spitalit Pediatrik QSUT me dg. Konvulsione tetanike? status post kafshimit nga qeni, suspekt rabies.

Ankesat e fëmijës në shtrrim: Nuk mbushet me frymë, kontraksione në extremitetet, pa temperaturë.

- Diten e martë pasdite dt. 30. 08. 2005 në fshatin Gërman fëmija kafshohet në shpatull nga qeni i komshiut. Infermierja e fshatit i mjekon plagën dhe i rekomandon prindërve ta dergojnë fëmijen në spital.
- Të nesërmen ditën e mërkurë dt. 31. 08. 2005 e ëma e dërgon fëmijet tek gjyshërit e saj në Fushë Krujë pa kaluar dhe njoftuar shërbimin spitalor të rrëthit.
- Gjatë asaj dite tek shtëpia e gjyshes (e mërkurë 31. 08. 2005), fëmija nuk paraqiti ndonjë shqetësim.
- Të nesërmen ditën e enje dt. 01.09.2005 fëmija paraqet shqetësimi si dridhje, vështirësi në fryshtëmarrje, vështirësi në ecje, pa temperature.
- Këto shqetësimi u shtuan me kalimin e orëve deri sa në mbrëmje të po asaj dite (01.09.2005) fëmija dërgohet urgjentisht dhe shtrohet në QSUT.
- Në dt. 02.09. 2005 ditën e premte spitali pediatrisk njofton dep. e Epidemiologjisë për një rast suspekt rabies.
- Me marrjen e denoncimit preqatitet ekipi i per tu nisur urgjentisht për të kryer hetimin epidemiologjik në rrëthim e Matit. Njoftohet shërbimi i Epidemiologjisë dhe shërbimi Veterinar i rrëthit Mat.
- Informohet IKV per rastin dhe gjithashtu bashkë me ekipin e IShP vjen edhe një mjek veteriner i IKV.
- Në DSHP e rrëthit ekipi kontakton me epidemiologun, mjekun e zonës dhe veterinerin e rrëthit dhe së bashku nisen në fshatin Gërman.
- Në ambulancën e fshatit kontrollohet regjistri i vaksinimit përfëmijen dhe kontaktet familjare. Vaksinimi rezultoi sipas skemës.
- Nga kontakti me Xh. D. fqinj me familjen e fëmijës, qeni i të cilit e kishte kafshuar, rezulton se qeni ishte i pa vaksinuar kundër tèrbimit.
- Që prej 10 ditësh qeni kishte marrë një plagë në fytyrë dhe kishte ndryshuar sjelljen. Dyshimi ishte që mund të ishte përlleshur me ndonjë ujk të cilët kanë mbipopulluar zonën përreth fshatit.
- Mbasi u diskutua rasti në vend dhe nisur nga të dhënat epidemiologjike dhe veterinare u vendos që qeni të ekzekutohet dhe koka e tij të dërgohet për ekzaminim të mëtejshëm në lab përkates të IKV.
- Për të gjitha veprimet u mbajt proces-verbal i përkatës si dhe j'u la detyrë shërbimit epidemiologjik dhe veterinar të rrëthit që kjo zonë të mbahet në observim dhe përf qdo gjë të dyshimit të njoftohet IShP
- Koka e qenit sillet në Lab. e IKV per ekzaminimin e trurit përf praninë e virusit të tèrbimit.
- Në dt. 03. 09.2005 ekzaminimi rezulton negativ përf virusin e tèrbimit.

### Konkluzion

Rabies u përjashtua si diagnose sepse meqenëse nuk u gjet virusi në trurin e qenit, supozohet që virusi nuk ndodhet as në pështymën e tij.

Përsa i përket tetanozit, fëmija nuk kishte temperature por gjithashtu nuk paraqiti as pozicionin karakteristik *opistotonus* të tetanozit.

Nga ekzaminimet e mëtejshme rezultoi që fëmija kishte çregullime të gjendrës së hipofizës e cila shkaktoi paralizat e ngjashme me tetanozin.

Ishë thjesht rastësi që kafshimi i qenit ndodhi pikërisht dy ditë para se fëmijës t'i shfaqeshin simptomat. Gjithsesi, në momentin që vihet diagnoza *suspekt Rabies*, hetimi epidemiologjik duhet të shkojë deri në fund

## Përshkrimi i monitorimit të cilësisë së ajrit në Shqipëri gjate vitit 2004

ELIDA MATA, AGRON DELIU, ARBEN LUZATI,  
PRANVERA ZACE

Ajri i jashtem urban eshte i ndotur nga agjente te ndryshem te demshem qe mund te rezultojne me rritje te mortalitetit dhe morbozitetit nepermjet ekspozimeve ne kohe te shkurter dhe te gjate.

Efektet e shendetit human nga cilesia e dobet e ajrit jane teper te shtrira, por kryesisht ata ndikojne ne sistemin respirator dhe ate kardio/vaskular. Reagimet individuale nga ndotesisit e ajrit varen nga tipi i ndotesisit ne te cilen personi eshte i ekspozuar, shkalla e ekspozimit, gjendja shendetesore e individit dhe formimi gjenetik. Njerezit te cilet kryejne aktivitetin e tyre ne mjevide te jashtme, p.sh ne ditet e ngarkuara me smog risin ekspozimin e tyre ndaj ndoteseve te ajrit. Efektet shendetesore te shkaktuara nga ndotesisit e ajrit mund te radhiten nga ndryshimet te lehta biokimike dhe fiziologjike deri ne veshtiresite ne frymëmarjje, azmatike, kolle te vazhdueshme dhe acarim te gjendjeve ekzistuese te sistemit respirator dhe kardiak.

Ne procesin e monitorimit te ajrit urban ne vendin tone jane te perfshire 7 (shtate) rrethe te vendit tone te cilet jane: Tirana, Durresi, Elbasani, Fieri, Vlora, Shkodra dhe Korca.

Ne treguesit e ndotjes se cilesise se ajrit qe ne arrijme te nxjerrim vlerat e permabjtura jane: LGS, PM10, Pb, SO<sub>2</sub>, NO<sub>2</sub> dhe O<sub>3</sub>.

### ► Qellimi

Qellimi i paraqites se treguesve te ndotjes se ajrit urban te cilet ne monitorojme ne shtate rrethet e vendit eshte njohja me saktesi te besueshme kohore e hapsinore te cilesise se ajrit urban ne keto rrethe gjate vitit 2004.

### ► Pershkrimi i per gjithshem

Gjatë periudhes Janar-Dhjetor 2004, në Tirane jane marre mostra ajri ne 5 stacione per 13 dite /muaj. Po keshtu eshte vepruar edhe ne qytetet Shkoder, Durrës, Vlore dhe Korçë, por ne 1 stacion ne secilin. Në Fier janë bërë matje në 2 pika, te cilet jane perfaqesuar nga Drejtoria e Higjene - Epidemiologjise dhe në fshatin Zharrëz pranë fushës naftembajtse Patos-Marinëz. Ne Elbasan jane marre mostra ne tre pika: Elbasani 1 si zakonisht ne Drejtoren e Higjene – Epidemiologjise, Elbasani 2 (Drejtoria e Kombinatit metalurgjik) dhe Elbasani 3 (godina e universitetit). Eshte i treti vit radhazi që mostrat e ajrit merren parimisht në të njejtat pika, gjë që përbën avantazh për nxjerrjen e tendencave. Te gjitha keto mostra jane analizuar rregullisht çdo muaj ne laboratorin e ajrit te ISHP.

**Bashkëngjitur jepen karakteristikat baze qe perfaqesojne stacionet e monitorimit.**

<b>Stacionet</b>	<b>Perfaqesimi</b>
Tirana 1	Poliklinika qendrore, lartesia e matjes 10 m
Tirana 2	Pazari i ri, lartesia e matjes 10 m
Tirana 3	ISHP, lartesia e matjes 15 m
Tirana 4	Kryqezimi i 21 Dhjetorit, lartesia e matjes 3 m
Tirana 5	DHE, lartesia e matjes 5 m
Durres	Poliklinika qendrore, lartesia e matjes 10 m
Elbasani 1	DHE, lartesia e matjes 6 m
Elbasani 2	Kombinati metalurgjik, drejtoria qendrore
Elbasani 3	Universiteti, lartesia e matjes 1,5 m
Fieri 1	DHE, lartesia e matjes 10 m
Fieri 2	Zhares, lartesia e matjes 3 m
Korca	DHE, lartesia e matjes 6 m
Shkodra	DHE, lartesia e matjes 6 m
Vlora	Poliklinika qendrore, lartesia e matjes 6 m

## ► Metodologjia

Medotologjia e marries se mostres realizohet nga metoda aktive (LGS, PM10, NOx, SO2) dhe pasive (NOx, O3), nepermjet pompare te vendosura ne stacionet e monitorimit. Nxjerra e rezultateve te ndotjes analizohet ne laboratorin e Cilesise se Ajrit bazuar ne metodologjine e percaktuar sipas standardeve te OBSH.

Metodologjikisht, mesatarja per çdo indeks eshte 13 dite monitorim/muaj qe rekordonohet nga OBSH dhe ECEH (doc. EUR/ICP/TRNS 020102, year 1997). Ne kete theksojme se NO<sub>2</sub> ka minimumin e domosdoshem 274 dite matje/vit ose 22.4 dite matje/muaj.

Rezultatet e hollesishem te monitorimit te ajrit, Janar - Dhjetor 2004 (mesatare vjetore) te rretheve ne monitorimi.

**Pasqyra.1 Treguesit e ndotjes sipas stacioneve te monitorimit, qyteti i Tiranes, viti 2004. ( $\mu\text{g m}^{-3}$ )**

<b>Stacionet</b>	<b>LGS</b>	<b>PM10</b>	<b>Pb</b>	<b>SO2</b>	<b>NO2</b>	<b>O3</b>
<i>Tirana 1 lartesia e matjes 10 m</i>	280	126	0.2	16	40	97
<i>Tirana 2 lartesia e matjes 10 m</i>	233	108	0.16	13	31	100
<i>Tirana 3 lartesia e matjes 15 m</i>	151	67	0.13	14	23	102
<i>Tirana 4 lartesia e matjes 3m</i>	965	432	0.3	26	57	93
<i>Tirana 5 lartesia e matjes 5 m</i>	219	99	0.2	13	21	103
<i>Tirana 5 lartesia e matjes 5 m</i>	219	99	0.2	13	21	103
<i>Norma jone</i>	140	60	1	60	60	120
<i>Norma BE</i>	80	50	0.5	50	40	120

Pasqyra.2 Treguesit e ndotjes sipas stacioneve te monitorimit, qyteti i Elbasanit, viti 2004. ( $\mu\text{g m}^{-3}$ )

<b>Stacionet</b>	<b>LGS</b>	<b>PM10</b>	<b>Pb</b>	<b>SO2</b>	<b>NO2</b>	<b>O3</b>
Durres,lartesia e matjes 10 m	209	95	0.34	12	18	99
<i>Norma jone</i>	140	60	1	60	60	120
<i>Norma BE</i>	80	50	0.5	50	40	120

Pasqyra.3 Treguesit e ndotjes sipas stacioneve te monitorimit, qyteti i Durresit, viti 2004. ( $\mu\text{g m}^{-3}$ )

<b>Stacionet</b>	<b>LGS</b>	<b>PM10</b>	<b>Pb</b>	<b>SO2</b>	<b>NO2</b>	<b>O3</b>
Elbasani1,lartesia e matjes 6 m	244	112	0.22	17	23	94
Elbasan2	468	157	0.53	33	34	88
Elbasan3 lartesia e matjes 1,5 m	201	88	0.23	10	17	105
<i>Norma jone</i>	140	60	1	60	60	120
<i>Norma BE</i>	80	50	0.5	50	40	120

Pasqyra.4 Treguesit e ndotjes sipas stacioneve te monitorimit, qyteti i Fierit, viti 2004. ( $\mu\text{g m}^{-3}$ )

<b>Stacionet</b>	<b>LGS</b>	<b>PM10</b>	<b>Pb</b>	<b>SO2</b>	<b>NO2</b>	<b>O3</b>
Fieri1 lartesia e matjes 10 m	227	105	0.34	19	23	92
Fieri2 lartesia e matjes 3 m	117	46	0.05	18	6.3	100
<i>Norma jone</i>	140	60	1	60	60	120
<i>Norma BE</i>	80	50	0.5	50	40	120

Pasqyra.5 Treguesit e ndotjes sipas stacioneve te monitorimit, qyteti i Vlores, viti 2004. ( $\mu\text{g m}^{-3}$ )

<b>Stacionet</b>	<b>LGS</b>	<b>PM10</b>	<b>Pb</b>	<b>SO2</b>	<b>NO2</b>	<b>O3</b>
Vlore lartesia e matjes 6 m	157	69	0.43	10	17	103
<i>Norma jone</i>	140	60	1	60	60	120
<i>Norma BE</i>	80	50	0.5	50	40	120

Pasqyra.6 Treguesit e ndotjes sipas stacioneve te monitorimit, qyteti i Korces, viti 2004. ( $\mu\text{g m}^{-3}$ )

<b>Stacionet</b>	<b>LGS</b>	<b>PM10</b>	<b>Pb</b>	<b>SO2</b>	<b>NO2</b>	<b>O3</b>
Korca lartesia e matjes 6 m	137	56	0.21	8	11	90
<i>Norma jone</i>	140	60	1	60	60	120
<i>Norma BE</i>	80	50	0.5	50	40	120

Pasqyra.7 Treguesit e ndotjes sipas stacioneve te monitorimit, qyteti i Shkodres, viti 2004. ( $\mu\text{g m}^{-3}$ )

<b>Stacionet</b>	<b>LGS</b>	<b>PM10</b>	<b>Pb</b>	<b>SO2</b>	<b>NO2</b>	<b>O3</b>
Shkodra lartesia e matjes 6 m	229	103	0.46	9	14	95
<i>Norma jone</i>	140	60	1	60	60	120
<i>Norma BE</i>	80	50	0.5	50	40	120

## ► Përfundime e Rekomandime

Rezultatet mesatare të paraqitur në tabelat përbledhëse te mësipërme tregojnë vazhdimin e një situate tashmë jo te stabilizuar, të cilësisë së ajrit urban. Ndotësit më të rëndësishëm vazhdojnë të janë pluhuri total LGS dhe ai i respirueshëm PM 10. Me përashtime të pak qyteteve që mund të konsiderohen relativisht të pastër në këtë pikëpamje (Vlorë dhe Korçë), tërë qytetet e tjerë kanë tejkalime të konsiderueshëm të këtyre indekseve. Në këtë kontekst Tirana vazhdon të jetë qyteti me i ndotur me një tejkalim mesatar prej rreth dy herësh, ku pika e 21 Dhjetorit konsiderohet e rrezikshme për shëndetin e njerëzve, me tejkalim të rendit mbi 6-7 herë..

1. Sipas klasifikimit zyrtar të Britanisë së Madhe, pluhuri i respirueshem PM10 i konsideruar ndotësi më i rëndësishëm i ajrit urban në Europë e më gjërë, trajtohet si shumë i rrezikshëm për shëndetin e njerëzve kur haset në ajrin urban në përbajtje më të larta se  $100 \mu\text{g}/\text{m}^3$ . Ai konsiderohet normal në përbajtje më të ulta se  $49 \mu\text{g}/\text{m}^3$ . Në rezultatet e përfthuar tek ne, 7 pika nga 14 të monitoruara në krejt territorin i kanë këto përbajtje mbi  $100 \mu\text{g}/\text{m}^3$ , sidomos pika e 21 Dhjetorit e ka mesatarisht  $432 \mu\text{g}/\text{m}^3$ .

2. Gjatë vitit 2004 janë ndjekur për herë të parë edhe dy pika të reja monitoruese, ajo e zonës së banuar tek ndërtesa e universitetit të Elbasanit, si edhe ajo e zonës së banuar të fshatit Zharrëz që konsiderohet si pikë industriale, te lidhura keto me ndikimin e fushës naftënxjerrëse të Patos-Marinzës.

3. Në Elbasan ka patur një zhvillim pozitiv mjedisor gjatë viti 2004, në pikëpamje të marrjes së masave teknike për pakësimin e shkarkimeve ndotëse në ajër. Fabrika e cimentos ECF qysh në fund të muajit prill ka vënë në përdorim sistemin e plotë të kapjes së pluhurave prej shkarkimeve të saj. Rezultatet e përbajtjes së pluhurave në ajrin e dy pikave urbane të qytetit të Elbasanit e konfirmojnë këtë ndikim pozitiv. Pika e tretë e monitorimit të cilësisë së ajrit në këtë rajon, ajo në afersi direkte me ish Kombinatin Metalurgjik, rezulton me përbajtje të ndotësve më të rëndësishëm të ajrit të rendit rreth dy herë më të lartë se pikat urbane brenda në qytet (**shih pasqyren. 2**). Kjo lidhet qartësisht me shkarkimet ndotëse të zonës industriale përkatëse, ku burimet kryesorë për nga rëndësia janë uzina e shkrirjes së çelikut KURUM, uzina e shkrirjes së ferrokromit DARFO, ish uzina e petëzimit dhe dy fabrika tullash.

4. Edhe matjet në pikën e Zharrës (Fieri 2), pasqyrojnë qartë rolin e madh të shkarkimeve nga zona e nxjerrjes së naftës ne prishjen e cilësisë së ajrit atmosferik të krejt zonës. Ndërsa indekset e tjerë jo specifikë të karakterit urban janë brenda normave të lejuara.

